



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3182/6 prot.

Datë 11.12.2025

V E N D I M

Nr. 1838 / 2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e dates 11.12.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64980-10-15-2025, me objekt “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorise së M.Z.SH.-se Fier”, me fond limit: 1,025,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

Shfuqizimi i vendimit të KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së operatori ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A me Nipt J91329003O, Adresa: Komuna e Parisit, Pall. Lura, Kati. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier
Adresa: Lagjja Kastrioti, Rr. “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier..

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-64980-10-15-2025, me objekt “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-se Fier”, me fond limit: 1,025,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

II.2. Në datën 27.10.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.3 Në datën 03.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike përkatësisht:

1. “Sigma Vienna Insurance Group” Sh.A. 1,025,000 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 04.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Anulimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6055, datë 06.11.2025 dhe me Nr. 3182/2025 Prot., date 06.11.2025 e operatorit ekonomik “Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A, për procedurën e prokurimit me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në këtë procedurë prokurimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi Formularin për publikim, nr. 3182/1 prot, datë 07.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Me arsyet e skualifikimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. rezulton se, operatori ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. ka paraqitur Licensën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit nr. 1/1999 dt. 30.09.2014, me objekt “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jojetë, në territorin e Republikës së Shqipërisë” ku në aneksin e saj janë përcaktuar klasat e sigurimit për ushtrimin e veprimtarisë jojetë si vijon:

Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale)

Klasa 2. Sigurimi i sëmundjeve;

dhe nuk janë të përfshirë rastet e vdekjes si rezultat i aksidentit në punë.

Nga kqyrja e ekstraktit të QKR – së, shoqëria “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a rezulton me status aktiv dhe ka si objekt të aktivitetit të saj Sigurimin ndaj dëmeve dhe risigurimi dhe nuk ka të përcaktuar sigurimin e jetës së punonjësve nga aksidentet në punë me pasoje vdekje.

II.7. Me shkresën ardhur në sistem, me nr. 11512/12 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3182/2, datë 11.11.2025, dhe me shkresën ardhur me postë me nr. 11512/12 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3182/3, datë 13.11.2025 Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës, referuar të cilit ka vendosur; Mospranim të pretendimeve të ankesës.

II.8. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6068, datë 12.11.2025 dhe me Nr. 3235/2025 Prot., date 12.11.2025 e operatorit ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-64980-10-15-2025, me objekt “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-se Fier”, me fond limit: 1,025,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e Vendimit nr.11512/11 Prot., datë 11.11.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, lidhur me Refuzimin e Ankesës së paraqitur nga Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A.

II.9.Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi Formularin për publikim, nr. 3235/1 prot, datë 13.11.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e Vendimit të KSHA-së mbi mospranimin e pretendimeve të operatorit ankimes “Sigma Vienna Insurance Group”, Sh A si më poshtë vijon:

[...]Në datën 03.11.2025, jemi informuar nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik te Agjencise se Prokurimit Publik se oferta jone eshte refuzuar me arsyetimin se Licensa e shoqerise Sigma Vienna Insurance Group Sh.A nuk mbulon ngjarjen e vdekjes si rezultat i aksidentit ne pune. Duke mos qene dakord me kete vendim, kemi paraqitur ankim prane Bashkise Fier dhe KPP njekohesisht ne perputhje me parashikimet e ligjit. Ankesa jone eshte refuzuar nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave te Bashkise Fier nepermjet vendimit nr. 11512/11 prot., date 11.11.2025 dhe per kete arsye paraqesim kete ankim prane KPP.

Pretendimi i ngritur ne arsyet e refuzimit se Licensa e Shoqerise Sigma Vienna Insurance Group Sh.A nuk mbulon ngjarjen e vdekjes si rezultat i aksidentit ne punë eshte i pabazuar. Licensa e shoqerise tonë i ka te percaktuar qarte klasat e sigurimit per te cilat eshte e licensuar/autorizuar nga autoriteti i mbikqyrjes financiare per te ushtruar veprimtarine e sigurimit joqete, dhe nder te tjera eshte specifikuar

Klasa 1: sigurimi i aksidenteve (perfshire plagosjet industriale dhe semundjet profesionale). Licensimi ne kete klase sigurimi eshte bere ne perputhje me ligjin nr. 52/2014 per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit date, 22.05.2014, i cili ne aneksin nr. I liston klasat e sigurimit duke permendur klasen 1 sebashku me nenpikat e saj, si me poshte:

1. Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale) mbulon:

1.1 pagesën e një shume të caktuar monetare (pagesa e menjëhershme e plotë);

1.2 përfitim me natyrë rimbursimi (pagesa e shumës sësigurimit me këste);

1.3 kombinimin e 1.1 dhe 1.2;

1.4 pagesën ndaj dëmtimeve shëndetësore ose vdekjes së pasagjerëve

Kjo klase sigurimi ka per qellim sigurimin e ngjarjeve aksidentale ne te cilat perfshihen individed e siguruar. Dhe siguruesi eshte i detyruar te paguaje ndaj perfituesit demshperblimin perkates (pika 1.1: pagesën e një shume të caktuar monetare (pagesa e menjëhershme e plotë) , ne rast se vertetohet ndodhja e ngjarjes aksidentale te mbuluar nga polica e sigurimit. Nuk eshte ne qellimin e ligjvenesit te listoje te gjitha ngjarjet aksidentale qe mbulohen nga klasa 1 e sigurimit.

Asgjekundi ne ligjin nr. 52/2014 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit nuk specifikohen ngjarjet konkrete aksidentale apo te nje natyre tjeter. Por kjo klase thekson qarte se mjafton qe ngjarja te jete aksidentale, per t'i lindur e drejta siguruesit per ta siguruar sipas nje police sigurimi. Te gjitha ngjarjet e permendura ne piken 4 te VKM-se nr. 382, date 13.05.2020 "Për sigurimin e jetës te punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", jane ngjarje aksidentale ne pune te punonjesve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi dhe per rrjedhoje referuar arsyetimit me siper, jane plotesisht te sigurueshme nga shoqeria Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Kjo e fundit ka siguruar edhe punonjes te shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ne bashki te tjera ...

Sa më siper, bazuar ne nenin 114 e vijues te ligjit 162/2020, kerkojme pranimin e ankimit tone drejtuar KPP dhe pranimin e ofertës ekonomike se Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Ne proceduren mësipërme të prokurimit dhe vijimin e saj.[...]

II.10. Me shkresën informacion, ardhur në sistem, me nr. 11512/14 prot., datë 13.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 32352/2, datë 13.11.2025, si edhe Shkresa ardhur me shërbim postar me nr. 11512/14 prot., datë 13.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 32352/3, datë 17.11.2025, me anë të të cilave Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës, referuar të cilit ka vendosur: Të mos marrë në shqyrtim të pretendimet e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP, rezulton se, operatori ekonomik SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP ka paraqitur Licensën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit nr. 1/1999 dt. 30.09.2014, me objekt "Për të ushtruar veprimtari sigurimi jojetë, në territorin e Republikës së Shqipërisë" ku në aneksin e saj janë përcaktuar klasat e sigurimit për ushtrimin e veprimtarisë jojetë si vijon:

Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale)

Klasa 2. Sigurimi i sëmundjeve;

dhe nuk janë të përfshirë rastet e vdekjes si rezultat i aksidentit në punë.

Nga kqyrja e ekstraktit të QKR – së, shoqëria "Sigma Vienna Insurance Group" sh.a rezulton me status aktiv dhe ka si objekt të aktivitetit të saj Sigurimin ndaj dëmeve dhe risigurimi dhe nuk ka të përcaktuar sigurimin e jetës së punonjësve nga aksidentet në punë me pasoje vdekje.

III.1.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në SPE, Shtojcën 6, Specifikimet Teknike si më poshtë:

Specifikimi i Materialeve:

Kontrata e sigurimit te jetes nga aksidentet te punonjeve te MZSH mbulon ngjarjet aksidentale sipas pikes 4 te VKM nr.382 dt.13.05.2020 “Per sigurimin e jetes se punonjesve te Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin” dhe shuma e percaktuar ne kontraten e sigurimit, per cdo punonjes te siguruar do te jete sipas pikes 5 te kesaj VKM.

Kushtet standarde te kontrates se sigurimit, perfshire tabelen e koeficienteve te perfitimit ndaj demtimeve trupore, te miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, do te shërbejnë si kushte minimale, te detyrueshme per t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve. (pika 7 e VKM nr.382 dt.13.05.2020 “Per sigurimin e jetes se punonjesve te Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”).

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohen: “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-së Fier”

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga momenti i nenshkrimit te kontrates (policies se sigurimit).

Nr.	Emërtimi	Nr. i personave për sigurim
1.	Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-së Fier	41

Sipas pikes 5 te VKM “Shuma e percaktuar ne kontraten e sigurimit per cdo punonjes te siguruar nuk mund te jete me e ulet se 5.000.000 (pese milion) leke” dhe sipas pikes 6 “Tarifa e primit te sigurimit percaktohet ne kontraten e sigurimit, por nuk mund te jete me e ulet se 0.5%”. Bazuar ne VKM e mesiperme perlllogaritja e fondit limit si me poshte: 5 000 000 x 0.5% = 25 000 leke

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-së Fier”

Detyrat:

Kontrata e sigurimit te jetes nga aksidentet te punonjeve te MZSH mbulon ngjarjet aksidentale sipas pikes 4 te VKM nr.382 dt.13.05.2020 “Per sigurimin e jetes se punonjesve te Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin” dhe shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit, për çdo punonjës të siguruar do te jete sipas pikes 5 te kesaj VKM.

Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, do te shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve. (pika 7 e VKM nr.382 dt.13.05.2020 “Per sigurimin e jetes se punonjesve te Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”).

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Drejtoria e M.Z.SH, Bashkia Fier

Shtojca 9.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

2.3 Kapaciteti teknik:

- 1.3.2 Licensë përkatëse e lëshuar nga autoriteti kompetent e vlefshme për fushën e veprimtarisë së sigurimeve sipas legjislacionit në fuqi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar.

Referuar **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim**

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PER PROCEDUREN E HAPUR E THJESHTUAR ME MJETE ELEKTRONIKE

1.3.2 Licensë përkatëse e lëshuar nga autoriteti kompetent e vlefshme për fushën e veprimtarisë së sigurimeve sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në pikën 4 /a te nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: „4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a)licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, si dhe në ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

III.1.2. Operatori ekonomik në përmbushje të Kritereve për Kualifikim, Kriterit 1.3.2. ka depozituar në SPE Dokumentet si vijon:



Licensa_SIVIG.pdf

Në brendi të të cilit gjendet:

Licencë për Ushtrimin e Veprimtarisë së Sigurimit me Nr. 1/1999, datë 30.09.2014,

Për SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP Sh.A.

Bashkëlidhur Aneksi i Klasave të Sigurimit.

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III. 1.4. Në nenin 41, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, pikat 1,2, 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

III.1.5. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.6. Operatori ekonomik, ka paraqitur në SPE dokumentet e ofertës në përmbushje të kriterëve kualifikuese e konkretisht të Kriterit 1.3.2. sipërcituar në pikën III.1.2..

Komisioni vëren, se operatori ekonomik ofertues është subjekti i parë i interesuar në plotësimin e dokumenteve të tenderit me saktësi dhe përpikëri, më qëllim që oferta e tij të rezultojë e vlefshme.

Komisioni i Prokurimit Publik, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Sigma Vienna Insurance Group” Sh.A. kanë të bëjnë përkatësisht me përmbushjen të kriterëve për kualifikim: *[...]Asgjëkundi në ligjin nr. 52/2014 Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit nuk specifikohen ngjarjet konkrete aksidentale apo te*

nje natyre tjeter. Por kjo Klase thekson qarte se mjafton qe ngjarja te jete aksidentale, per t'i lindur e drejta Siguruesit per ta siguruar sipas nje police sigurimi. "Sigma Vienna Insurance Group" Sh.A, ... Të gjitha ngjarjet e permendura ne piken 4 te VKM-se Nr. 382, date 13.05.2020 Për Sigurimin e Jetës së Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, jane ngjarje aksidentale ne pune te punonjesve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe për rrjedhoje referuar arsytimit me sipër, jane plotesisht të sigurueshme nga shoqeria Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. Kjo e fundit ka siguruar edhe punonjes te Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ne Bashki te tjera si Berat, Lezhe etj. [...] Komisioni mori në shqyrtim DST, dokumentin ProcesVerbal "Mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", dhe konstaton se Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e kriterit 1.3.2 e konkretisht apo specifikuar konkretisht: Autoritetin Kompetent për lëshimin Licencave, Objektin e Licencave të operatorëve ekonomikë apo edhe Klasat e sigurimit të cilat duhet të përputhen me informacionin e paraqitur nga dokumentet e paraqitura nga operatorët ekonomikë dhe çdo informacion që jep spjegime të qarta mbi përmbushje të kriterit objekt gjykimi, të dhëna të cilat duhet të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave. Në këtë kontekst kriteri është i paqartë dhe konfuz si edhe mënyra e plotësisht të këtij kriteri nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucione të autorizuar por edhe për autoritetin kontraktor është e vështirë mënyra e vlerësimit të ofertave të paraqitura duke vendosur arsye skualifikimi të paqarta dhe të pambështetura në kriterë konkrete.

Komisioni thekson se, një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit ndaj qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit mbi baza të një vlerësimi objektiv të tyre. Në rastin konkret kriteri i mësipërm ka vendosur në kushte të paqarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra nuk është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik në lidhje paraqitjen e dokumenteve të kërkuara. Në këtë mënyrë Komisioni Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter konfuz dhe diskriminues.

Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma "b" të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, sipas të cilit: *"Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma "d" të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: "Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj", si dhe në nenin 45, pika 1 gërma "b" të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", ku parashikohet se: "[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" [...]"*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se Kriteri **1.3.2** “*Licensë përkatëse e lëshuar nga autoriteti kompetent e vlefshme për fushën e veprimtarisë së sigurimeve sipas legjislacionit në fuqi*”, është kriter evaziv, përjashtues, vështirëson operatorët, krijon konfuzion për për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi.

Mospërcaktimi i saktë dhe shterues i kriterëve për kualifikim por edhe të gjitha dokumentet e procedurës të cilat japin informacion të nevojshëm, përbëjnë shkak për vlerësimin e kualifikimin në përputhje me kriteret për kualifikim, specifikimet teknike dhe terma reference të pa argumentuara e të paqarta.

Në përfundim të analizës së fakteve Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi, duke hartuar një kriter të saktë dhe të qartë në përputhje me parashikimet ligjore dhe konstatimet e këtij vendim.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Në lidhje me ankimin elektronik A/2025/6068, datë 12.11.2025 dhe me Nr. 3235/2025 Prot., date 12.11.2025 të operatorit ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. me objekt: kundërshtimin e Vendimit të KSHA-së mbi mospranimin e pretendimeve të operatorit ankimues “Sigma Vienna Insurance Group”, Sh A, I cili argumenton si më poshtë vijon:

[...]Në datën 03.11.2025, jemi informuar nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik te Agjencise se Prokurimit Publik se oferta jone eshte refuzuar me arsyetimin se Licensa e shoqerise Sigma Vienna Insurance Group Sh.A nuk mbulon ngjarjen e vdekjes si rezultat i aksidentit ne pune. Duke mos qene dakord me kete vendim, kemi paraqitur ankim prane Bashkise Fier dhe KPP njekohesisht ne perputhje me parashikimet e ligjit. Ankesa jone eshte refuzuar nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave te Bashkise Fier nepermjet vendimit nr. 11512/11 prot., date 11.11.2025 dhe per kete arsye paraqesim kete ankim prane KPP. Pretendimi i ngritur ne arsyet e refuzimit se Licensa e Shoqerise Sigma Vienna Insurance Group Sh.A nuk mbulon ngjarjen e vdekjes si rezultat i aksidentit ne punë eshte i pabazuar. Licensa e shoqerise tonë i ka te percaktuara qarte klasat e sigurimit per te cilat eshte e licensuar/autorizuar nga autoriteti i mbikqyrjes financiare per te ushtruar veprimtarine e sigurimit joqete, dhe nder te tjera eshte specifikuar [...]

III.2.1. Komisioni mori në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik dhe konstaton se në referim të nenit 111/1/2/4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ankesa rezulton në mospërmbushje të kushteve formale, duke mos paraqitur mandat pagesë për këtë ankesë.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon të mos e marrë në shqyrtim ankesën me nr. 3235/2025 prot., datë 12.11.2025 të operatorit ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64980-10-15-2025, me objekt “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-se Fier”, me fond limit: 1,025,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues operatorit ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. me nr. 3182/2025 Prot., date 06.11.2025, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64980-10-15-2025, me objekt “Sigurimi i jetës nga aksidentet në punë të punonjësve të Drejtorisë së M.Z.SH.-se Fier”, me fond limit: 1,025,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.
2. Të mos marrë në shqyrtim ankesën nr. 3235/2025 prot., datë 12.11.2025 të operatorit ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A. për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me ripublikimin e saj të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor përpara publikimit të procedurës së prokurimit të sjellë pranë KPP-së kopje të DST me modifikimet përkatëse.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Sigma Vienna Insurance Group, Sh.A.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

